

Broshurë teknike

EPOXYCOAT-W

Shtresë epokside me bazë ujin dhe me 2 përbërës

Përshkrimi

EPOXYPRIMER-W është një sistem epoksid me bazë ujin me 2 përbërës. Ai ofron fortësi dhe rezistencë të lartë ndaj gërryerjes. Ai është rezistent ndaj acideve, materialeve alkaline, produkteve të naftës, ujit, ujit të detit, kushteve të motit etj. Është ideal për përdorime në ambiente të mbyllura dhe në përgjithësi, në rastet kur tretësit nuk janë të dëshirueshëm.

Certifikuar sipas standardit EN 1504-2 dhe klasifikuar si shtresë për mbrojtjen e sipërfaqeve të betonit.

Fushat e përdorimit

EPOXYCOAT-W përdoret si shtresë mbrojtëse dhe dekorative për nënshtresat me bazë çimentoje, p.sh. beton, suva, laç çimentoje, si dhe në sipërfaqe metalike. E përshtatshme për njësi industriale, laboratore, thertore, fabrika të ushqimeve të konservuara, tunele, fabrika vere, pika karburanti, servise makinash etj. Gjithashtu është e përshtatshme për sipërfaqet me kontakt të drejtpërdrejtë me produktet ushqimore, sipas W-347, EPA 330.5 dhe EPA 110.2.

Të dhënat teknike

Baza:	rrëshirë epokside me 2 përbërës
Ngjyrat:	RAL 7035 (gri e lehtë) RAL 1015 (ngjyrë bezhë), E ngjyrosshme në ngjyra të tjera RAL përmes bazave P dhe TR të disponueshme
Viskoziteti:	4,200 mPa.s (+23°C)
Densiteti:	1,32 kg/litër
Raporti i përzierjes (A:B):	100:23, sipas peshës
Koha e punueshmërisë:	rreth 90 minuta (+20°C)
Temperatura minimale e mpiksjes:	+8°C
Koha e shkeljes:	pas 24 orësh (+23°C)
Shtresa pasuese:	pas 8 deri në 48 orë (+23°C)

Fortësia finale: pas 7 ditësh (+23°C)

Rezistenca ndaj fërkimit: < 3.000 mg
(EN ISO 5470-1)

Përthithja kapilare dhe përshkueshmëria nga uji: 0,01 kg/m²·h^{0,5}
(EN 1062-3, kërkesë për EN 1504-2: w < 0,1)

Rezistenca ndaj goditjes së temperaturës
(EN 13687-5): a) s'ka, ashpërsi, plasaritje ose rënie
b) Rezistenca në ngjitje: ≥ 2 N/mm²

Rezistenca ndaj ndikimit: 5 Nm (Klasa I)
(EN ISO 6272-1)

Forca ngjitëse: > 3 N/mm² (pika e thyerjes së betonit)

Përshkueshmëria nga CO₂: Sd > 200 m
(EN 1062-6)

Reagimi ndaj zjarrit: B-s1,d0*
(EN 13501-1)

*Nr. i certifikatës: 20/23451-1854, APPLUS Laboratories, Spanjë, Tetor 2020.

Pastrimi i veglave:

Veglat duhet të pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqja që do të vishet duhet të jenë:

- E thatë dhe e qëndrueshme.
- Pa materiale që pengojnë ngjitjen, si p.sh. pluhuri, grimcat e lira, grasoja etj.
- E mbrojtur nga sulmi i lagështirës nga poshtë.

Gjithashtu, ajo duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Nënshtresat me çimento

Cilësia e betonit: të paktën C20/25

Cilësia e laçit të çimentos: përmbajtja e çimentos
350 kg/m³

Mosha: të paktën 28 ditë

Niveli i lagështirës: më pak se 4%

EPOXYCOAT-W

b) Sipërfaqet prej hekuri ose çeliku

Duhet të jenë pa ndryshk ose pa ndonjë papastërti që pengon ngjitjen. Në varësi të natyrës së nënshtresës, ajo duhet të trajtohet nëpërmjet fërkimit me furçë, gërryerjes, rërës apo ujit me ajër me presion, etj. Në vijim të kësaj, sipërfaqja duhet të pastrohet me fshesë me vakum, me fuqi të madhe thithëse.

2. Lyerja me astar

a) Nënshtresat me çimento

Sipërfaqet me bazë çimentoje lyhen duke përdorur EPOXYCOAT-W të holluar me ujë deri në 20% të peshës.

Konsumi i EPOXYCOAT-W: ~ 150 g/m².

b) Nënshtresat metalike

Nënshtresat metalike duhet të lyhen me materialin epoksid anti-korroziv EPOXYCOAT-AC, në një apo dy shtresa.

Konsumi i EPOXYCOAT-AC: ~ 150 g/m²/shtresë.

3. Përzjerja e EPOXYCOAT-W

Përbërësit A (rrëshira) dhe B (forcuesi) pakëtohen në dy enë të veçanta, në raportin e saktë të përzjerjes në lidhje me peshën. Fillimisht, përbërësi A duhet të përzihet për 1 minutë. Më pas, e gjithë përmbajtja e përbërësit B i shtohet përbërësit A. Përzjerja e 2 përbërësve duhet të bëhet për rreth 5 minuta, duke përdorur një mikser me shpejtësi të ulët (300 rpm). Është e rëndësishme që përzjerja të trazohet plotësisht pranë anëve dhe fundit të enës në mënyrë që të arrihet përhapja uniforme e forcuesit.

4. Përdorimi - Konsumi

EPOXYCOAT-W duhet të përdoret brenda 48 pas lyerjes dhe pasi është tharë astari. Aplikohet me rul, furçë ose spërkatje, të paktën në 2 duar (shtresa). Shtresa e parë e EPOXYCOAT-W përdoret siç është ose hollon me ujë deri në 10% të peshës. Shtresa (dora) e dytë bëhet pasi të jetë tharë dora e parë, por brenda 48 orësh.

Konsumi: 150-250 g/m²/shtresë.

Ambalazhimi

EPOXYCOAT-W ofrohet në paketime (A+B) prej 3 kg dhe 9 kg, ku përbërësit A dhe B kanë një raport të fiksuar të peshës.

Magazini

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin original të izoluar, në ambiente të mbrojtura nga lagështira dhe ekspozimi në dritën e diellit. Rekomandohet një temperaturë ruajtjeje midis +5°C dhe +35°C.

Shënime

- Punueshmëria e materialeve epokside ndikohet nga temperatura e tyre. Temperatura ideale e përdorimit është midis +15°C dhe +25°C në mënyrë që produkti të jetë i lehtë për t'u përdorur dhe për t'u tharë, ashtu siç shpjegohet më lart. Temperatura e ambientit nën +15°C do të rrisë kohën e tharjes dhe temperatura mbi +30°C do të përshpejtojë kohën e tharjes. Gjatë dimrit rekomandohet një ngrohje paraprake e produktit, kurse në verë rekomandohet ruajtja e materialit në një vend të freskët përpara përdorimit.
- Ngjitja e shtresa pasuese mund të ndikohet ndjeshëm nga ndërhyrja e lagështirës ose papastërtive.
- Nëse një kohë më e gjatë se ajo e parashikuar ndodh midis aplikimeve të shtresave pasardhëse ose në rast se dyshemetë e vjetra do të shtrohen përsëri, sipërfaqja duhet të gërryhet dhe të pastrohet plotësisht përpara aplikimit të një shtrese të re.
- Përpara përdorimit, lexoni këshillat e sigurisë të treguara në etiketën e produktit.
- EPOXYCOAT-W është synuar vetëm për përdorim profesional.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "j", lloji WB është 140 g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim EPOXYCOAT-W përmban maksimumi 140 g/l VOC.

EPOXYCOAT-W



2032

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

12

2032-CPD-10.11

DoP No. : EPOXYCOAT-W/1825-01

EN 1504-2

Surface protection products

Coating

Abrasion resistance: < 3000 mg

Capillary absorption: $w < 0,1 \text{ kg/m}^2 \cdot \text{h}^{0,5}$

Resistance to thermal shock: $\geq 2,0 \text{ N/mm}^2$

Impact resistance: Class I

Adhesion strength: $\geq 2,0 \text{ N/mm}^2$

Reaction to fire: Euroclass B-s1,d0

Dangerous substances comply with 5.3

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 576 029

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu